



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Gllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 400/01-11328 dt. 30/03/ 2026



Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40 të për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, si dhe në bazë të nenit 12, paragrafët 12.1 dhe 12.2 pika d), nenit 90, pika 1 të Ligjit Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera, si dhe Rregullores (QRK) Nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera. Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.03.2026 miratoi këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Raportit përfundimtar të Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera

Neni 1

Me këtë Vendim, në përputhje me nenin 31, paragrafi 1.1 të Rregullores (QRK) Nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera, propozohet miratimi i Raportit përfundimtar të Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera.

Neni 2

Me miratimin e këtij Vendimi nga Kuvendi i Komunës, konfirmohet vlerësimi i dëmeve në shumën totale prej 17,265.06 €, për dëme në bujqësi gjatë vitit 2025.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi përgjegjës janë: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjente dhe Drejtoria për Bujqësi.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Bujupi

ARSYETIM

Raporti përfundimtar i Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera është hartuar në përputhje me Ligjin Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera dhe me Rregulloren (QRK) Nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera.

Në bazë të këtyre akteve normative, komunat obligohen të themelojnë komisione për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. Përmes këtij komisioni është realizuar procesi i vlerësimit me qëllim të përcaktimit të llojit dhe madhësisë së dëmit në të mira materiale, të shprehura në vlerë monetare, e nevojshme për rikthimin e tyre në gjendjen paraprake, përkatësisht për blerjen ose riparimin e tyre.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Kryetari i Komunës, pas dhënies së pajtimit të tij, obligohet ta dorëzojë raportin në Kuvendin Komunal për shqyrtim dhe miratim. Pas miratimit nga Kuvendi, raporti dorëzohet brenda afatit prej 15 ditësh në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, si dhe një kopje i përcillet Komisionit Qendror për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera, i cili bën vlerësimin e korrektësisë së tij dhe evidenton mangësitë eventuale.

Duke marrë parasysh sa më sipër, si dhe rekomandimet e Komisionit Qendror lidhur me procedurën e shqyrtimit të raporteve të komunave për vlerësimin e dëmeve në të mira materiale dhe ndikimin e fatkeqësive të tjera, propozohet që, brenda afatit ligjor dhe në përputhje me nenin 31, paragrafi 1.1 të Rregullores (QRK) Nr.17/2015, të miratohet ky Propozim-Vendim.

Fw: Pergjigje- Shkresë përcjellëse nga MAPL

Erblin Hetemi

Fri 4/3, 4:03 PM

Vjosa Ahmetaj; Gafurr Sllamniku

From: Kastriot Lajqi
Sent: Friday, April 3, 2026 8:20 AM
To: Erblin Hetemi
Cc: Shefki Abdullahu; Alketa Islamaj; Drijana Mehmeti
Subject: Pergjigje- Shkresë përcjellëse nga MAPL

I nderuar,

Po ju njoftojë se Vendimi i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit lidhur me dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në aspektin procedural është në harmoni me legjislacionin në fuqi.

Ndërsa në aspektin përmbajtësor Komisioni Qendror për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera i themeluar me Vendimin Nr. 14/99 të datës 30.09.2022 e Qeverisë së Republikës së Kosovës bazuar në Ligjin Nr. 04/-L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, Rregulloren (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, shqyrton raportet për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera të cilat i kompletton tutje për procedim dhe i dërgon për miratim përfundimtar në Qeveri.

From: Shefki Abdullahu <Shefki.Abdullahu@rks-gov.net>
Sent: Wednesday, April 1, 2026 3:10 PM
To: Kastriot Lajqi <Kastriot.Lajqi@rks-gov.net>
Cc: Ramiz Lladrovci <Ramiz.Lladrovci@rks-gov.net>; Burim Bujupi <Burim.Bujupi@rks-gov.net>; Rinore Zymeri <rinore.zymeri@rks-gov.net>; Bekim Dobra <Bekim.Dobra@rks-gov.net>; Liridona Ajazi <Liridona.Ajazi@rks-gov.net>; Erblin Hetemi <erblin.hetemi@rks-gov.net>; Xhevat Tafa <Xhevat.Tafa@rks-gov.net>; Vjosa Ahmetaj <Vjosa.Ahmetaj@rks-gov.net>; Edita A. Azemi <edita.a.azemi@rks-gov.net>; Erlinda Smirqaku <erlinda.smirqaku@rks-gov.net>
Subject: FW: Shkresë përcjellëse nga MAPL

PIT

Sh.A

Nga: Shkrimorja Mapl <Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net>
Dërguar: Wednesday, April 1, 2026 12:21 PM
Për: Shefki Abdullahu <Shefki.Abdullahu@rks-gov.net>
Cc: Ramiz Lladrovci <Ramiz.Lladrovci@rks-gov.net>; Burim Bujupi <Burim.Bujupi@rks-gov.net>; Rinore Zymeri <rinore.zymeri@rks-gov.net>; Bekim Dobra <Bekim.Dobra@rks-gov.net>; Liridona Ajazi <Liridona.Ajazi@rks-gov.net>;

6/2/26, 11:36 AM

mail.rks-gov.net/owa/projection.aspx

Erblin Hetemi <erblin.hetemi@rks-gov.net>; Xhevat Tafa <Xhevat.Tafa@rks-gov.net>; Vjosa Ahmetaj <Vjosa.Ahmetaj@rks-gov.net>; Edita A. Azemi <edita.a.azemi@rks-gov.net>; Erlinda Smirqaku <erlinda.smirqaku@rks-gov.net>

Tema: Shkresë përcjellëse nga MAPL